



sipas Vendimit për ndarje të mjeteve për studime pasuniversitare "Gabriela Konevska Trajkovska" jashtë vendit, në fushën e drejtësisë, ekonomisë, dhe politikave të BE-së, për vitin akademik 2014/2015, i miratuar në mbledhjen e 197 të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, mbajtur me datë 15.04.2014, (Gazeta zyrtare nr. 65/2014, 17.04.2014), si dhe Vendimit për lotësimin e Vendimit për ndarje të mjeteve për studime pasuniversitare "Gabriela Konevska Trajkovska" jashtë vendit, në fushën e drejtësisë, ekonomisë, dhe politikave të BE-së, për vitin akademik 2014/2015 nga mbledhja e 12 e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e mbajtur në 29.07.2014 (Gazeta zyrtare nr. 114/2014, 31.07.2014), Sekretariati për Çështje Evropiane i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, rishpall:

KONKURSI

**PËR NDARJE TË BURSIVE PËR STUDIME PASUNIVERSITARE JASHTË VENDIT
"GABRIELA KONEVSKA TRAJKOVSKA"
NGA FUSHA DREJTËSISË, EKONOMISË DHE POLITIKAVE TË BE –SË
PËR VITIN AKADEMIK 2014/2015**

Me studime pasuniversitare nga fusha e BE-së, nënkuptohen studimet pasuniversitare nga fusha e drejtësisë, ekonomisë dhe politikave të BE-së jashtë vendit, me ç'rast përparësi do t'u jepet kandidatëve të cilët nuk kanë siguruar mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve të studimeve në fushat e lartpërmendura.

Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet në vazhdim:

- të jetë qytetar i Republikës së Maqedonisë;
 - të posedojë diplomë universitare për shkollim të lartë adekuat, të kryer, dhe vërtetim për provimet e dhëna, me pikë të fituara prej 180 deri në 240 ECTS ose të jetë në vitin e fundit të studimeve, me kusht që të njëjtat të jenë të përfunduara më së voni deri më 31 korrik të vitit 2014;
 - përparësi do të kenë kandidatët me mesatare të lartë, si dhe kandidatët nga universitetet e ranguar lartë sipas rangimit nacional;
 - të dëshmojë që zotëron shkëlqyeshëm gjuhën angleze (TOEFL, IELTS, ose të dorëzojë vërtetim tjetër relevant për kryerjen e ndonjë shkollimi jashtë vendit, në gjuhën angleze, apo të vërtetojë që për periudhë të gjatë kohore e ka përdorur gjuhën e huaj si rezultat i banimit të përkohshëm ose qëndrimit më të gjatë në një shtet të huaj dhe faktorë të tjerë relevant për njohje të gjuhës). Njohja e gjuhëve të tjera të shteteve anëtare të BE-së do të logaritet si përparësi;
 - të dorëzojë vërtetim nga Universiteti ku do të regjistrohet si dëshmi që i plotëson kushtet për regjistrim në fakultetin përkatës dhe që është i pranuar në programin e caktuar për të cilin ka aplikuar për studime pasuniversitare, që zgjasin një vit akademik (deri në 12 muaj), në fushën e drejtësisë, ekonomisë dhe politikave të BE-së. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte të konfirmime nga fakultetet që janë më lartë të ranguar në listën e Shangajit;
 - të dorëzojë dokumentacionin e plotë për aplikim sipas shpalljes nga neni 4: formular të plotësuar për aplikim, biografi në gjuhën maqedonase dhe angleze, link nga programi i studimeve, gjegjësisht tek lista e lëndëve që përfshihen në studime, vërtetim relevant për njohjen e gjuhës angleze, diplomë universitare për shkollim adekuat të lartë të përfunduar me vërtetim për provimet e dhëna, vërtetim/komunikim apo dokument për pranimin e aplikimit të studimeve dhe letër motivuese në gjuhën maqedonase dhe angleze;
- Kushtet për ndarje të bursave, formularët për aplikim, si dhe informacionet tjera do të jenë të disponueshme në ueb faqen zyrtare të Sekretariatit për Çështje Evropiane pas shpalljes së konkursit.

Nuk do të merren parasysh aplikimet e kandidatëve të cilët:

- kanë dorëzuar dokumentacion jo të plotë;
- kanë aplikuar pas afatit përfundimtar për aplikim në konkurs;
- që kanë regjistruar dhe/ose janë duke ndjekur studime pasuniversitare në fushën e BE-së jashtë vendit;
- që janë para përfundimit të studimeve pasuniversitare ose sapo kanë përfunduar studimet pasuniversitare në fushën e BE-së jashtë shtetit;
- që kanë kryer studim pasuniversitare në Republikën e Maqedonisë dhe kërkojnë bursë për studime të dyta pasuniversitare;
- që kanë filluar procedurë për regjistrim ose janë regjistruar në studime pasuniversitare në fushën e BE-së jashtë vendit, të cilat zgjasin më shumë se 12 muaj.

Dhënësi i bursës obligohet t'i mbulojë shpenzimet në lartësi deri në 20.000,00 euro në kundërvlerë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës. Shpenzimet që kalojnë shumën, do të jenë në barrë të marrësit të bursës. Mjetet ndahen për mbulimin e shpenzimeve për regjistrim, akomodim, ushqim dhe shpenzimet e rrugës për shkuarje dhe kthim deri në destinacionin ku do të studiohet.

Aplikimi për këtë konkurs duhet të përbëjë në formë elektronike dokumentet në vijim:

- formular të plotësuar për aplikim në konkursin për ndarje të bursave për studime pasuniversitare nga fusha e BE-së;
- biografi në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze [EU format];
- link nga programi i studimeve pasuniversitare; nëse nuk ka link apo nëse programi nuk është i dhënë në internet atëherë duhet të dorëzohet listë e lëndëve prej të cilave përbëhet programi;
- vërtetim që e zotëron shkëlqyeshëm gjuhën angleze (TOEFL, IELTS, ose vërtetim tjetër relevant për kryerje të studimeve jashtë vendit, në gjuhën angleze, apo të dëshmojë që një periudhë të gjatë kohore e ka përdorur gjuhën e huaj si rezultat i banimit të përkohshëm ose qëndrimit më të gjatë në një shtet të huaj dhe faktorë të tjerë relevant për njohje të gjuhës);
- diplomë universitare për shkollim të lartë adekuat të kryer dhe vërtetim për provimet e kaluara; në qoftë se është në vitin e fundit të studimeve, vërtetim për provimet e kaluara;
- Vërtetim/komunikim për pranimin e dokumenteve, respektivisht aplikimit

për studime pasuniversitare për BE/IE në institucion të lartë arsimor jashtë

vendit;

- Letër me të cilën do të shprehen motivet për konkurrim, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze.

Formulari për aplikim dhe EU formati i biografisë mund të gjenden në internet faqen zyrtare të Sekretariatit për Çështje Evropiane:

<http://www.sep.gov.mk/content/?id=87>. I njëjti, gjithashtu mund të merret edhe në arkivin e Sekretariatit për Çështje Evropiane apo me kërkesë të kandidatit potencial, mund të dërgohet edhe me anë të postës.

Konkursi është shpallur me datë **07.08.2014** me afat deri me **30 ditë**, kurse afati përfundimtar për aplikim është më **05.09.2014** deri në ora **23:59**.

Në datë 18.08.2014 (e enjte) në ora 10:00, në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane në rrugën Kej Dimitar Vlahov nr.4, Shkup (ndërtesa e mëparshme e Bankës Komerciale) do të mbahet ditë informative, ku do të mund të merren informacione më të hollësishme lidhur me bursat.

Përzgjedhjen e aplikacioneve e kryen Komisioni përkatës. Pas përzgjedhjes së parë, kandidatët që plotësojnë kushtet administrative do të thirren në intervistë. Sipas propozim-listës të marrë nga Komisioni, zgjedhjen e kandidatëve e bën Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Kandidatët e zgjedhur nënshkruajnë **marrëveshje** me Sekretariatit për Çështje Evropiane të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Kandidatët e zgjedhur janë të obliguar të **punojnë në administratë shtetërore** në periudhë prej **3 viteve** pas kryerjes së studimeve pasuniversitare.

Për zgjedhjen përfundimtare të kandidatëve do të informohen të gjithë kandidatët të cilët janë paraqitur në konkurs, në afat prej 8 ditësh nga dita e zgjedhjes përfundimtare.

Aplikacionet dërgohen në **mënyrë elektronike** në e-mail adresën: stipendii@sep.gov.mk, ku mund të marrin dhe informacione shtesë për bursat.

Aplikacionet mund të dërgohen gjithashtu përmes postës në adresën:

**Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Sekretariati për Çështje Evropiane**

(shpallje për ndarje të bursës "Gabriela Konevska Trajkovska" për studime pasuniversitare për BE)

Kej Dimitar Vlahov nr.4

1000 Shkup

ose personalisht të dorëzohen me zarf të mbyllur në arkivin e Sekretariatit për Çështje Evropiane, më së voni deri në datën e lartpërmendur.

